AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN), 2022

30.11.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) për vitin 2022.

Tregtia me qarkullimin më të madh në 2022

Sipas rezultateve në nivel vendi, gjatë vitit 2022, gjithsej numri i ndërmarrjeve aktive për sektorët ekonomikë të mbuluar në anketë brenda periudhës së vrojtuar ishte 46 157[1] .

Gjithsej numri i ndërmarrjeve aktive në sektorët e përfshirë në anketë, gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021, ka shënuar rritje për 1,5%. Rritja më e madhe vërehet tek sektori i Prodhimit me 5,7%.

Gjithsej numri i të punësuarve në sektorët e përfshirë në anketë është rritur për 8,3%. Derisa kishte ulje te Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 4,2%.

Qarkullimi i realizuar nga ndërmarrjet ka shënuar rritje në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, për 25,7%. Rritje të qarkullimit sipas sektorëve ekonomikë ka më së shumti te Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim (hotelet dhe restorantet) për 40,9%.

Paga mesatare kishte rritje në të gjithë sektorët ekonomikë për 12,7%.

Ndërkaq, kategoria e shpenzimeve ka pësuar rënie në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, për 23,6%.

[1]Në këtë numër përfshihen vetëm ndërmarrjet, që janë përdorur si kornizë për mostrën e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, duke përjashtuar sektorët A, K, O, P, Q, T dhe U.

Ndryshimet e treguesve kryesorë në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, sipas sektorëve ekonomikë (%)

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	Ndërmarrjet	Të punësuar	Qarkullimi	Paga mesatare	Shpenzimet
B	Xehtari dhe gurëthyes	1,8	131,8	6,2	42,3	-13,5
C	Prodhim	5,7	8,2	23,2	9,6	-23,0
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-4,8	-4,2	51,2	2,3	-25,8
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	-0,7	3,7	12,9	3,3	217,5
F	Ndërtimtari	-0,7	1,8	28,2	7,9	-23,9
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve, motoçikletave	2,8	9,0	23,1	12,1	-30,8
H	Transport dhe magazinim	2,0	10,4	24,6	11,1	-7,4
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	4,8	11,5	40,9	16,7	36,5
J	Informacion dhe komunikim	5,6	9,7	25,4	21,5	135,7
L,M,N,R,S	Aktivitete të sherbimeve të tjera	-4,2	5,6	19,1	20,2	10,6
	Gjithsej	**1,5**	**8,3**	**25,7**	**12,7**	**-23,6**

Numri i ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomikë

Gjithsej numri i ndërmarrjeve aktive në sektorët ekonomikë, të mbuluar në anketë, ishte 46 157. Në këtë numër nuk janë përfshirë: bujqësia, pylltaria, peshkimi, financat, arsimi, shëndetësia, aktivitetet e ekonomive familjare, si dhe administrata publike.

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve gjatë vitit 2022 i përket sektorëve: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve, motoçikletave (39,1%); Aktivitetet e shërbimeve të tjera (21,4%); Prodhimi (13,4%); Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim (9,9%); Ndërtimtaria (8,3%); Transporti dhe magazinimi (3,6%) etj.

Numri i të punësuarve sipas sektorëve ekonomikë

Numri i përgjithshëm i të punësuarve sipas rezultateve të anketës strukturore të ndërmarrjeve gjatë vitit 2022 ishte 252 748.

Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve ekonomikë ishte te: Tregtia (34,3%); Prodhimi (17,0%); Aktivitetet e shërbimeve të tjera (12,6%); Ndërtimtaria (10,3%), etj.

Shpërndarja e të punësuarve dhe të vetë-punësuarve sipas sektorëve ekonomikë për vitet 2019-2022 (%)



Paga mesatare sipas sektorëve ekonomikë

Paga mesatare bruto sipas këtij hulumtimi sillet nga 354 Euro në vitin 2015, në 463 Euro në vitin 2022. Paga mesatare më e lartë ishte te furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, derisa ajo më e ulëta ishte te akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim.

Paga mesatare sipas sektorëve ekonomikë për vitet 2015-2022 (Euro)

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
B	Xehtari dhe gurëthyes	472	489	490	468	431	598	426	606
C	Prodhim	325	322	307	321	326	327	349	382
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	615	702	714	765	807	958	946	968
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	369	464	456	494	412	499	530	547
F	Ndërtimtari	337	383	401	440	387	370	379	409
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë,riparimi i mjeteve, motoçikletave	306	302	311	328	363	349	379	425
H	Transporti dhe magazinimi	394	389	372	399	333	414	422	469
I	Akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	252	251	240	254	268	211	238	278
J	Informacion dhe komunikim	712	684	686	672	593	696	718	872
L,M,N,R,S	Aktivitete të sherbimeve tjera	308	266	265	287	392	391	433	521
	Paga mesatare bruto	**354**	**359**	**359**	**378**	**370**	**403**	**411**	**463**

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Qarkullimi sipas sektorëve ekonomikë

Qarkullimi më i madh i realizuar nga ndërmarrjet, sipas viteve ishte te tregtia me rreth 52,2%. Kurse, përqindje më të vogël të qarkullimit kishte te ndërmarrjet nga xehetaria dhe gurëthyesit me rreth 0,7% dhe ndërmarrjet me furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës me 0,6%.

Shpenzimet sipas sektorëve ekonomikë

Sipas rezultateve të anketës, prej vitit 2015 deri në vitin 2022, shpenzimet ose blerjet te tregtia ishin 56,8% e vlerës së përgjithshme të shpenzimeve të të gjithë sektorëve. Kurse, shpenzimet më të vogla ishin te: xehetaria dhe gurëthyesit (0,6%); furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete të revitalizimit të tokës (0,8%); akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim (1,8%), etj.

Struktura e shpenzimeve sipas seksioneve ekonomike për vitet 2015-2022 (%)

Seksionet	Përshkrimi i seksioneve ekonomike	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
B	Xehtari dhe gurëthyes	0,9	0,6	0,5	0,4	1,0	0,9	0,5	0,6
C	Prodhim	11,6	10,7	11,6	10,0	11,6	13,4	13,3	13,5
D	Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	6,9	8,4	5,7	6,8	5,4	6,2	4,7	4,6
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	0,9	0,6	0,4	0,3	0,4	0,6	0,2	0,8
F	Ndërtimtari	6,3	6,7	8,4	8,6	7,7	11,0	9,6	9,6
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve, motoçikletave	66,6	66,6	65,0	68,9	66,1	58,2	62,8	56,8
H	Transport dhe magazinim	1,8	2,4	3,1	1,4	2,3	2,9	3,2	3,9
I	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	1,0	1,1	1,1	1,3	1,9	1,5	1,0	1,8
J	Informacion dhe komunikim	2,1	1,4	2,3	0,9	1,3	1,9	1,1	3,4
L,M,N,R,S	Aktivitete të shërbimeve të tjera	2,0	1,6	2,0	1,4	2,4	3,4	3,5	5,1
	Gjithsej	**100**	**100**	**100**	**100**	**100**	**100**	**100**	**100**

Për më shumë informata lidhur me Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) për vitin 2022, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Investment